

20160300793

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13 44/14 dhe 192/15), në nenin 51 paragrafi (1) pika d) alineja 5 lidhësja "ose", shlyhet.

Në pikën d) alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 55 paragrafi (3) në pikat a) dhe b) fjala “shkrim”, shlyhet.

Neni 3

Në nenin 61 në paragrafin (2) fjalët: ”e vërtetuar në noter” shlyhen.

Neni 4

Në nenin 77 pas paragrafit (7) shtohen dy paragrafë të rinj (8) dhe (9) si vijon:

“(8) Personi zyrtar i Agjencisë i cili e udhëheq procedurën është i obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e pranimi të kërkesës me detyrë zyrtare t’i kërkojë provat për plotësimin e kushteve nga paragrafi (6) pikat a), b), g) dhe d) të këtij neni nga organi publik kompetent.

(9) Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i obliguar t’i paraqesë provat nga paragrafi (8) të këtij neni në afat prej tri ditëve nga dita e pranimi të kërkesës.”

Paragrafët (8), (9), (10) dhe (11) bëhen paragrafë (10), (11), (12) dhe (13).

Neni 5

Në nenin 77-a pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijon:

“(3) Personi zyrtar i Agjencisë i cili udhëheq me procedurën është i obliguar në afat prej tre ditë nga dita e pranimi të kërkesës me detyrë zyrtare t’i kërkojë provat për plotësimin e kushteve nga paragrafi (2) alinetë 1 dhe 4 të këtij neni nga organi publik kompetent.

(4) Personi zyrtar nga organi kompetent publik është i obliguar të paraqesë provat e kërkuara nga paragrafi (3) të këtij neni në afat prej tre ditë nga dita e pranimi të kërkesës.”

Neni 6

Në nenin 106 në paragrafin (5) fjala “shkrim” shlyhet.

Neni 7

Në nenin 121 në paragrafin (2) fjala “shkrim” shlyhet.

Neni 8

Në nenin 136-g pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7) si vijon:

“(6) Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të Agjencisë nëse nuk i kërkon provat me detyrë zyrtare në afat prej tre ditë nga pranimi i kërkesës në pajtim me nenin 77 paragrafi (8) dhe 77-a paragrafi (3) të këtij ligji.

(7) Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të organit kompetent publik nëse nuk i paraqet provat e kërkuara me detyrë zyrtare në afat prej tre ditë nga pranimi i kërkesës në pajtim me nenin 77 paragrafi (9) dhe 77-a paragrafi (4) të këtij ligji.”

Paragrafi (6) bëhet paragraf (8).

Neni 9

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

Neni 10

Dispozitat e neneve 2,3,4,5,6,7 dhe 8 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër124/15).

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.”